



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

PROCESVERBAL
Nga mbledhja e V-të për vitin 2011, e Kuvendit
Komunal në Vushtrri, mbajtur më 26.5.2011

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën **10:10**. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO-së (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë.

Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit- tha se rendi i ditës nuk ka ardhë në bazë të planit vjetor të Kuvendit, duke shtuar se i mungojnë disa pika siç janë: qarkorja buxhetore (që është paraparë për muajin maj); pastaj nuk kemi qenë të informuar për disa aktivitete që janë paraparë, siç është 9 maji, Dita e Evropës; gjithashtu për takimet e poeteshave nuk kemi asnjë informatë lidhur me përgatitjet e këtij manifestimi. Mandej sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë është i obligueshëm, por nuk e kemi të përgatitur raportin tremujor nga Kryetari i Komunës.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- tha se kur është fjala për financa, çdo tre muaj paraqet informatë Drejtoria e Buxhetit, kurse me plan të punës së Kuvendit, Kryetari i Komunës raporton para Kuvendit çdo gjashtë muaj. Kurse lidhur me aktivitetet tjera që kanë qenë pjesë e planit të punës së Kuvendit, tha se i ka informuar të gjithë anëtarët e Kuvendit për datën 22 maj, kurse për 9 majin nuk ka pas ndonjë organizim nga Komuna e Vushtrrisë.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- lidhur me kërkesën e Q.Azemit për qarkoren buxhetore, njoftoi se Drejtoria për Buxhet dhe Financa është

furnizuar me propozimin e Ministrisë së Financave me qarkoren buxhetore, duke ia dërguar të njëjtën secilës drejtori, kurse në seancën e ardhshme procedohet edhe për anëtarët e Kuvendit. Ndërsa për Ditën e Evropës nuk ka pasë ndonjë organizim. Kurse organizimi për ditët e poeteshave është në përgatitje e sipër. Lidhur me raportin e Kryetarit, tha se sikur të kishte kërkesë nga anëtarët e Kuvendit, ai do të raportonte, duke shtuar se në këtë seancë është informata nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa lidhur me realizimin e buxhetit për tre mujorin, kurse Kryetari i raporton Kuvendit çdo gjashtë muaj.

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së shprehu shqetësimin, pasi që kuvendi nuk po i përmbahet planit të punës, kurse lidhur me raportin tre mujor financiar, tha se bazuar në ligj janë të obliguara të gjitha subjektet të raportojnë në Ministrinë e Financave, kurse në Kuvend, në bazë të Ligjit mbi menagjimin financiar dhe përgjegjësitë, duhet të sillet raport, ndërsa informata që është paraqitur në këtë seancë bën fjalë vetëm për të hyrat e komunës, prandaj në emër të Grupit parlamentar të LDK-së kërkoi që për seancën e ardhshme të përgatitet raport financiar, ku duhet të përfshihen të gjitha shpenzimet dhe detyrimet e Komunës, duke e bërë praktikë të Kuvendit përgatitjen e raportit financiar të Komunës çdo tre muaj. Në vazhdim tha se kjo informatë nuk ka ndarje të të hyrave në periudha, përkundër asaj që Grupi parlamentar i LDK-së ka kërkuar një gjë të tillë disa herë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit- kërkoi që të futet në “të ndryshme” Propozim-vendimi për ndarje të plaketave dhe mirënjohjeve për nder të Ditës së Çlirimit.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- shprehu shqetësimin lidhur me shtyrjen e mbledhjes nga muaji mars në muajin prill, pasi që me këtë shtyrje, po shtyhen edhe punët e rëndësishme. Pastaj tha se në Kuvend duhet diskutuar për çështje shumë serioze, duke shtuar se çështja e sigurisë është një çështje fundamentale, dhe kërkoi që të merremi me këto çështje para se të ndodh ndonjë e keqe. Mandej tha se në disa raste Kryetari i Komunës është mirë që të na informon edhe pa paraqitur kërkesë për informim, dhe përmendi si shembull nevojën e informimit për çështje që janë me interes të përgjithshëm, siç është rasti i tejkalimit të problemeve për ndërtimin e urës në Prelluzhë, pastaj çështja e shëndetit publik ka shumë rëndësi të diskutohet në Kuvend, mandej çështja e ndërtimeve pa leje, çështja e uzurpimeve të tokës bujqësore, duke shtuar se Vushtrria prinë si komunë me sipërfaqet më të mëdha të tokës pjellore të shndërruara në tokë ndërtimore.

Islam Krasniqi, anëtar i Kuvendit- në emër të fshatit Maxhunaj paraqiti shqetësimin, pasi që nuk është punuar sa duhet në këtë fshat, me përjashtim të shtruarjes së një rruge dhe një kanalizimi, duke shtuar se vërshimet po shkaktojnë shumë dëme në fshatin Maxhunaj, dhe tani vërshimet e fundit i kanë dëmtuar mbi 15 shtëpi, dhe shtoi se KFOR-i i ka dëmtuar shumë, pasi që uji po vjen nga baza e tyre, dhe gypat nuk po munden me përballuar, dhe kërkoi që të ndryshohet kahja, ashtu siç ka qenë më parë, në mënyrë që të evitohen vërshimet në të ardhmen.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- propozoi rendin e ditës ashtu siç është në ftesë, duke ia shtuar rendit të ditës në “të ndryshme” Propozimvendimin për ndarje të plaketave dhe mirënjohjeve për nder të Ditës së Çlirimit.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi në mënyrë unanime aprovoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i ekstraktit nga shënimi zyrtar me rastin e mosmbajtjes së mbledhjes së KK-së, më 29.03.2011.
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së, mbajtur më 21.04.2011.
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e KK-së, mbajtur më 28.04.2011.
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me realizimin e buxhetit Janar-Mars/2011, dhe inkasimin e të hyrave vetjake për muajin Janar-Mars/2011.
5. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për shërbimin e transportit me “merimangë” për territorin e Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.59/11 për dhënien në shfrytëzim të tokës së komunës.
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndarje të mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për pagesë të qirasë së banimit.
8. Shqyrtimi i propozimit të KPF-së për rritjen e numrit të anëtarëve të KPF-së dhe të Komitetit për Komunitete.
9. Shqyrtimi i kërkesës nga HANDIKOS-i, nga Vushtrria për ndihmë financiare.
10. Të ndryshme:
 - a. Propozim-vendimi për ndarje të plaketave dhe mirënjohjeve për nder të Ditës së Çlirimit.
 - b. Pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

1. Shqyrtimi i ekstraktit nga shënimi zyrtar me rastin e mosmbajtjes së mbledhjes së KK-së, më 29.03.2011.

Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit- tha se mungon fjalimi i tij, me këtë përmbajtje: kërkoj që të bëhet rekrutimi i kuadrove në spitalin e Vushtrrisë me mjekë specialist dhe atë për 2 gjinekolog, 1 internist, 1 transfuziolog, 1 pediatër, dhe 1 biokimist. Tutje ai arsyetoi se plotësimi i këtyre vendeve do të ndikonte në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, dhe në ruajtjen e imazhit të mirë të Spitalit të Vushtrrisë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:
Aprovohet ekstrakti në fjalë i Kuvendit të Komunës, me vërejtjen e paraqitur nga: P.Pllana.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së, mbajtur më 21.04.2011.

Aprovohet në mënyrë unanime procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, pa vërejtje dhe sugjerime.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e KK-së, mbajtur më 28.04.2011.

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- në faqen nr. 18, në fjalimin e tij, mungon fjalia "...material ndërtimor për vitin 2010...".

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- në faqen nr. 5, në fjalimin e tij, mungon fjalia "...në zbatim të...".

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet procesverbali i mbledhjes së fundit të Kuvendit të Komunës, me vërejtjet e paraqitura nga: I.Gashi dhe B.Jashari.

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me realizimin e buxhetit Janar-Mars/2011, dhe inkasimin e të hyrave vetjake për muajin Janar-Mars/2011.

Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit- tha se informata në fjalë është në nivel sa i përket cilësisë së informatës, por paraqiti disa vërejtje: lidhur me sektorin e financave publike, ku thuhet se në tre mujorin e parë të vitit 2011 janë përgatit 980 aktvendime mbi ngarkesën e taksës komunale, dhe tha se e njëjta fjali ka qenë e paraqitur edhe vitin e kaluar, kurse sipas Drejtorisë për Ekonomi thuhet se janë të regjistruara 2820 biznese, pra është një neglizhencë sa i përket shpërndarjes së aktvendimeve mbi ngarkesën e taksës komunale. Pastaj tha se ka kërkuar edhe më herët dhe përsëri kërkoi në emër të Grupit parlamentar të AAK-së që të sillet raport i detajuar mbi të hyrat e painkasuara për vitet paraprake, pasi që shumë komuna kanë paraqitur këtë raport, ndërsa komuna jonë akoma nuk e din sa i ka të hyra të painkasuara dhe borxhe që nuk mund t'i mbledhë. Gjithashtu kërkoi një raport nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim mbi numrin e saktë të bizneseve të regjistruara, si dhe të formoi një ekip mbi regjistrimin e të punësuarëve në sektorin privat dhe të kemi një databazë dhe një statistikë sa i përket papunësisë në Komunën e Vushtrrisë.

Nystret Gërxhaliu, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar faqes nr 6 "Sektori i financave publike", tha se vitin e kaluar kemi pasë një pasqyrë nga Auditori i Brendshëm të numrit të bizneseve që nuk funksionojnë legalisht, nuk kryejnë obligimet ndaj komunës, prandaj pyeti se çka është bërë në këtë drejtim, qysh është gjendja tani dhe a është ndërmarrë diçka, pasi që bizneset e tilla paraqesin një konkurrencë jolojale për bizneset që kryejnë obligimet.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se në faqen nr. 1 në paragrafin e fundit përmendet muaji "prill", prandaj është gabim, pasi që informata në fjalë po paraqitet për periudhën janar-mars. Pastaj në tabelën në faqen nr.2 kërkoi sqarim pasi që në kategorinë e pagave për periudhën janar-mars buxheti ka qenë i planifikuar 1,735.400.99 €, është alokuar e njëjta shumë, kurse janë shpenzuar më shumë se gjysma e mjeteve vetëm brenda këtij tre mujori. Mandej lidhur me subvencionet dhe transferet, tha se nga kjo njësi buxhetore kanë mbetur vetëm 50 € për nëntë muajt e ardhshëm, prandaj edhe kjo tregon për nevojën e planifikimit më të mirë. Në vazhdim duke iu referuar "të hyrave vetjake për muajin janar-mars 2011" tha se është një mangësi pasi që mungon planifikimi për vitin 2010. Gjithashtu në tabelën faqe nr.5 mungon kolona për planifikimin për periudhën

janar-mars 2010. Në faqen nr.7 nuk ka asnjë të hyrë nga “reklamimi, publikimi në pronën komunale”, edhe pse planifikimi ka qenë 12.500 €, dhe kjo tregon që nuk është planifikimi në rregull. Në fund tha se inspektimi i ambientit është shumë me rëndësi, pasi që ambienti është plotësisht i ndotur, kurse nuk ka asnjë inspektim, dhe nuk ka as të hyra nga inspektimi i këtij ambienti.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- tha se pasi që nuk ka një formë standarde të raportimit në të gjitha komunat, raportet bëhen në forma të ndryshme. Pastaj duke iu referuar çështjes së ngritur nga Z.Hasani lidhur me shpërndarjen e aktvendimeve të taksës në firmë, tha se ato aktvendime janë përgatitur në fillim të vitit 2011, por që vazhdon edhe me tutje në muajt në vazhdim, sepse çdo ditë ka regjistrime të reja të bizneseve dhe ka shuarje të bizneseve. Mandej tha se ka shumë vështirësi për të identifikuar lokacionet e bizneseve, pasi që shumica prej tyre nuk kanë zyre afariste dhe nuk kemi numra të tyre të telefonit. Kurse sa i përket shqetësimeve të ngritura nga B.Jashari lidhur me kategorinë e investimeve kapitale, u përgjigj se paragrafet paraprake ia japin kuptimin e plotë asaj që është thënë në paragrafin e fundit. Mandej shtoi se alokimin e buxhetit e kanë marrë nga Ministria e Financave, dhe ky alokim ka qenë në këtë shumë, kurse mjetet që kanë mbetur shfrytëzohen në periudhën e tre mujorit të dytë, kurse sa i përket subvencioneve, tha se janë implementuar të gjitha vendimet që kanë qenë në fuqi dhe në bazë të planifikimit për këtë tre mujor janë shpenzuar mjetet që kanë qenë në dispozicion. Në vazhdim tha se nuk ka asnjë raport që e pasqyron në informatë planifikimin në vitin aktual dhe planifikimin e vitit paraprak.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- nuk u pajtua me arsyetimin e drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa se nuk i kanë adresat e bizneseve, pasi që secili biznes që regjistrohet duhet të ketë adresën, dhe pronari i biznesit duhet të ketë edhe numrin e telefonit.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- sqaroi se raportet të cilat i merr nga Drejtoria për Ekonomi për bizneset e regjistruara nuk përmbajnë numër të telefonit, përveç emrit të biznesit dhe rrugës, asnjë të dhënë tjetër nuk ka.

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- tha se të gjitha ligjet në fuqi nuk njohin biznese pasive, kurse sa i përket taksës në firmë, edhe këto biznese që janë paraqitur me zero janë të obliguara të paguajnë taksën në firmë, ndërsa sa i përket adresave, nëse hyhet në email adresën e ATK-së dhe e shkruan numrin e biznesit ose numrin fiskal, dhe aty e gjen adresën dhe numrin e telefonit. Pastaj lidhur me tabelën faqe nr.2 kërkoi sqarime për shpenzimet në paga në shumën prej 887,399 €, kurse planifikimi dhe alokimet janë 1,735,400 €, prandaj është e pakuptimtë pasi që ky planifikim është bërë në bazë të numrit të punëtorëve dhe koeficientëve të tyre. Në vazhdim propozoi që në këtë pasqyrë të shtohet një rubrikë dhe të thuhet “të hyrat për periudhën janar-mars të detyrimeve nga vitet e mëparshme”. Në fund kërkoi që të bëhet një planifikim real konform mundësive që ka komuna, kurse tek shtylla e krahasimit dhe planifikimit të futet një shtyllë tjetër dhe të quhet “informata menaxheriale”, pastaj shtoi se detyrimet nuk janë prezantuar në asnjë raport të komunës.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- lidhur me çështjen e pagave, tha se këto të dhëna janë të sakta, dhe janë marrë nga sistemi i menaxhimit të financave, duke shtuar se pagat me rritje janë marrë vetëm për muajin mars, kurse mjetet e mbetura do të realizohen në muajt në vijim. Pastaj tha se për këtë tre mujor nuk kanë dorëzuar plan të rrjedhës së parasë, për shkak se nuk ka qenë i aprovuar buxheti, dhe këtë alokim e ka bërë Ministria e Financave.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- paraqiti pakënaqësinë e tij lidhur me inkasimin e të hyrave vetjake për këtë tre mujor, edhe pse ka përmirësime në disa shtylla buxhetore, dhe ka tejkalime edhe të planifikimit, por shtoi se në raport me planifikimin e kaluar nuk janë realizuar të hyrat, prandaj kjo është brengosëse. Pastaj tha se mbetet që në veçanti të përmirësohen të hyrat në Drejtorinë për Urbanizëm, por edhe në drejtoritë tjera.

5. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për shërbimin e transportit me “merimangë” për territorin e Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar aktit përcjellës, tha se vërejtjet dhe sugjerimet që janë paraqitur nga organi propozues, më tepër janë vërejtje të karakterit formalo-juridik, e jo vërejtje që do të dilnin nga grupet e interesit me të cilat është mbajtur debati publik. Në vazhdim duke iu referuar përsëri aktit përcjellës, tha se pika nr. 5 duhet të precizohet dhe të thuhet “organit kompetent”, e jo “organeve kompetente”, pasi që kompetent për zgjidhjen e një çështjeje rreth një ankese është kompetent vetëm një organ. Te pika nr. 8, tha se para nenit 15 është neni 14, por ndoshta është menduar që të shtohet ndonjë paragraf. Mandej lidhur me nenin 2.4, kërkoi sqarime se si është menduar të realizohet çështja në fjalë. Në fund tha se te dispozitat përfundimtare mungon edhe çështja që me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e mëparshme.

Veli Karaça, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar çështjes së autoparkut, tha se operatori si përfitues i tenderit duhet ta siguron autoparkun, e jo komuna, duke shtuar që kjo Rregullore nuk e zgjidh këtë çështje, por vetëm e komplikon çështjen se ku vendosen automjetet që transportohen me “merimangë”. Pastaj te neni 1, tha se ka dallim “ndalimi” nga “parkimi”, duke pyetur se a është e arsyeshme që të transportohen edhe automjetet që ndalohen për disa minuta, që për zhvendosjen e tyre duhet të asistojnë edhe policia, prandaj kjo Rregullore duhet të flet vetëm për automjetet e parkuara, ose që qëndrojnë një kohë më të gjatë. Te neni 4.2, tha se nuk ka nevojë të jetë me mundësi vazhdimi, por duhet të shpallet tender i ri. Te neni 8.5, në vend të termit “preferuar”, të thuhet “obliguar”. Te neni 9, kërkoi që në vend të fjalisë “drejtuesit e automjeteve duhet”, por të thuhet “drejtuesit e automjeteve janë të obliguar”. Mandej tha se duhet të jetë një nen për të treguar se çka përfiton komuna prej kësaj kontrate, duke shtuar se nga një Rregullore e mëparshme, komuna ka përfituar 25 % prej pagesës së pronarit të automjetit për pagesën e transportimit deri në autopark. Te neni 14.1, propozoi që fjalisë “automjetet e braktisura”, t’i shtohet “të vendosura në pronën publike”.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- paraqiti vërejtje tek emërtimi i neneve, duke thënë se emërtimi duhet të vjen pas nenit, pastaj kërkoi që të bëhet renditja e neneve, pasi që nuk ka lidhje logjike të nenit me nen. Në vazhdim lidhur me nenin 1, tha se në vend të fjalës “rregullon”, të thuhet “përcakton”. Te neni 2.2, tha se në vend të fjalisë “...automjeti është i ndaluar...”, duhet thënë “...automjeti është i ndalur...”. Mandej tha se neni 6 duhet të renditet te neni 4.

Hajrullah Muli, anëtar i Kuvendit- te neni 10.1, paragrafi 2, tha se shuma prej 30 € është shumë e madhe, prandaj nuk pajtohet me shumën në fjalë, dhe propozoi shumën prej 15 €.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- propozoi që të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet të analizohen edhe një herë nga Drejtoria për Shërbime Publike, dhe të inkorporohen vërejtjet dhe propozimet në Rregulloren në fjalë, dhe në seancën e ardhshme të aprovohet.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Të inkorporohen vërejtjet dhe sugjerimet e anëtarëve të Kuvendit, dhe në mbledhjen e radhës së KK-së të aprovohet.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.59/11 për dhënien në shfrytëzim të tokës së komunës.

Nezir Klinaku, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër- njoftoi se në seancën paraprake është marrë vendimi për dhënien në shfrytëzim të tokës në pronësi të komunës për ndërtimin e objektit për qendrën e regjistrimit civil dhe regjistrimit të automjeteve në afat prej 10 viteve, kurse Ministria e Punëve të Brendshme ka kërkuar afat më të gjatë, prandaj në përputhje me ligjin propozoi afatin prej 40 viteve.

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- kërkoj sqarime shtesë, duke shtuar se është dashtë të kemi edhe pëlqimet nga ministritë përkatëse, ashtu siç thuhet në nenin 5.3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Nezir Klinaku, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër- tha se kërkesa ka qenë nga Ministria e Punëve të Brendshme, dhe se donatori ka kërkuar që të zgjatet afati në periudhën që është në përputhje me ligjin.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- kërkoj që të aprovohet propozim-vendimi në parim, pastaj të shqyrtohet nga juristët.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim plotësohet dhe ndryshohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë 01Nr.59/11, dt.28.04.2011 për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim, të tokës në pronësi të komunës, për ndërtim të Objektivit për Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve dhe Qendrën e Regjistrimit Civil.

Ndryshimi i Vendimit në fjalë bëhet sa i përket afatit të dhënies në shfrytëzim të pronës: prej afatit 10 vite me mundësi vazhdimi në afatin prej 40 vitesh.

7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndarje të mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për pagesë të qirasë së banimit.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se Komuna ka një donacion nga PTK-ja për ta bërë restaurimin e shtëpisë së Mahmut Agë Gjinollit, dhe është shpallë tenderi për restaurimin e një pjese të shtëpisë në fjalë, pasi që nuk mjafton donacioni për ta restauruar në tërësi, por paraprakisht duhet zhvendosur 8 familjet nga shtëpia në fjalë, duke gjetur forma ligjore për t'ua paguar qiranë këtyre familjeve.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- duke iu referuar nenit 1, propozoi që kohëzgjatja prej 6 muajve të rritet në 1 vit për pagesën e qirasë për banim të familjeve në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Lejohen mjete financiare nga buxheti i Komunës, nga fondi për subvencione në emër të pagesës së qirasë për banim në shumën prej 7200 € për periudhën prej një (1) viti.

Qiraja do të paguhet për 8 familje të cilat duhet ta lirojnë objektin e ish ambulancës së vjetër si dhe 4 familjet që kanë banuar nën tenda vitin e kaluar. Për çdo familje pagesa mujore është 100 €.

8. Shqyrtimi i propozimit të KPF-së për rritjen e numrit të anëtarëve të KPF-së dhe të Komitetit për Komunitete.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- tha se në bazë të ndryshimeve dhe plotësimeve të Statutit të Komunës, numri i anëtarëve të KPF-së rritet në 9 anëtarë, gjithashtu rritet në 9 anëtarë edhe Komiteti për Komunitete. Pastaj sqaroi se pjesë e anëtarëve shtesë të KPF-së do të jenë: 2 anëtarë nga PDK-ja, 1 anëtar nga AAK-ja, 1 anëtar nga LDK-ja dhe 1 anëtar nga AKR-ja.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- tha se edhe subjektet tjera politike që janë pjesë e Kuvendit Komunal duhet të përfaqësohen në komitetet obligative, dhe do të ishte transparenca më e mirë për Kuvendin dhe për qytetarët, duke shtuar që secili subjekt politik i ka 1.000 vota.

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- tha se së pari duhet të merret vendim për rritjen e numrit në 9 anëtarë, pastaj të paraqiten propozimet. Në vazhdim në emër të Grupit parlamentar të LDK-së propozoi për anëtar të KPF-së Pajazit Pllanën.

Bahrije Pllana, anëtare e Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së propozoi për anëtar të KPF-së Zeqir Hasanin.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit- tha se vendet për anëtarët e KPF-së dhe të Komitetit për Komunitete janë të përcaktuara me ligj. Pastaj në emër të Grupit parlamentar të PDK-së propozoi për anëtarë të KPF-së Habib Mustafën dhe Gani Imerin. Kurse Naile Osmanin për anëtare të Komitetit për Komunitete.

Islam Krasniqi, anëtar i Kuvendit- propozoi Tasim Gubetin (AKR) për anëtar të KPF-së.

Selvete Sholla, anëtare e Kuvendit- tha se nuk është e arsyeshme që të rritet numri i anëtarëve të Komitetit për Komunitete prej 7 në 9 anëtarë, pasi që ka disa muaj që nuk po funksionin komiteti në fjalë. Në fund kërkoi që mbledhjet e Komitetit për Komunitete të mbahen çdo muaj, pasi që është komiteti i përhershëm.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- njoftoi anëtarët e Kuvendit se nuk ka qenë i kënaqur me punën që ka bërë Komiteti për Komunitete, pasi që nuk i kanë raportuar asnjëherë Kuvendit, dhe kanë pas një rend dite të njëjtë për çdo mbledhje, prandaj si kryetar i Komunës ka menduar që është e mjaftueshme që komiteti në fjalë të mbajë takime (mbledhje) çdo tre muaj, por në rast nevojë të mbajnë takime edhe më të shpeshta, duke shtuar se nëse mendon Kuvendi që duhet mbajtur mbledhje çdo muaj, atëherë le të mbetet çdo muaj.

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- Grupi parlamentar i LDK-së propozon Syzana Sylën për anëtare të Komitetit për Komunitete.

Haki Maloku, përgjegjës për Sekretarinë e Kryetarit- sqaroi se në bazë të ligjit duhet të jenë më tepër se 50 % të anëtarëve të Komitetit për Komunitete nga përfaqësues të komuniteteve jo shumicë, e që nuk janë anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Sabri Ferati, anëtar i Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së propozoi Qazim Azemin për anëtar të Komitetit për Komunitete.

Ergin Sunguri, anëtar i Kuvendit- tha se është kundër rritjes së numrit të anëtarëve të KPF-së dhe Komitetit për Komunitete, sepse asgjë nuk po punohet, mirëpo nëse rritet numri i anëtarëve të Komitetit për Komunitete, nga KDTP-ja propozoi Enver Dubovcin.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- sqaroi se në Komitetin për Komunitete duhet të shkon vetëm një anëtar nga Kuvendi i Komunës, kurse anëtari tjetër plotësohet nga komunitetet jo shumicë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 22 vota “për”, 3 “kundër”, të tjerët “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim rritet numri i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF-së) prej 5 në 9 anëtarë.

Pastaj Kuvendi pas votimit me 26 vota “për”, të tjerët “abstenim”, vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim emërohen anëtarë shtesë të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF-së) siç vijon:

- 1. Habib Mustafa (PDK);***
- 2. Gani Imeri (PDK);***
- 3. Zeqir Hasani (AAK);***
- 4. Pajazit Pllana (LDK);***
- 5. Tasim Gubetini (AKR).***

Gjithashtu gjatë diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota “për”, të tjerët “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim rritet numri i anëtarëve të Komitetit për Komunitete prej 7 në 9 anëtarë.

Pastaj Kuvendi pas votimit me 18 vota “për”, të tjerët “abstenim”, vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim emërohen anëtarët shtesë të Komitetit për Komunitete, siç vijon:

- 1. Naile Osmani (PDK);***
- 2. Një përfaqësues nga komunitetet jo shumicë.***

9. Shqyrtimi i kërkesës nga HANDIKOS-i, nga Vushtrria për ndihmë financiare.

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- tha se këtë kategori duhet mbështetur çdo herë kur ekzistojnë mundësitë buxhetore, por brengosëse është që nga buxheti i Komunës shpenzohen mjete marramendëse, kurse një individ të kësaj kategorie nuk i dilet në ndihmë, pra bëhet fjalë për Valmir Avni Ramën, nga fshati Novolan, që vitin e kaluar prindi i tij ka kërkuar nga Komuna t’i sigurohet transporti për shkollë, por iu është refuzuar kërkesa personit në fjalë.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se Komuna e ka të pamundur që të mbulojë të gjitha rastet që paraqiten për t’iu ndihmuar. Pastaj për rastin e paraqitur nga I.Gashi, tha se nuk ka pasur mundësi që të realizohet kërkesa në fjalë, se përndryshe do t’i ndihmohej edhe personit në fjalë. Në vazhdim tha se HANDIKOS-i është një prej shoqatave joqeveritare që funksionon më së miri. Në fund tha se edhe kërkesa për Valmir Avni Ramën do të shqyrtohet përsëri.

Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit- e mbështeti kërkesën e shoqatës HANDIKOS. Pastaj tha se këtë kërkesë do ta plotësonte dhe do ta bënte më valide paraqitja e numrit të personave me nevoja të veçanta në Komunën e Vushtrrisë, afati kohor i cili duhet të respektohet për t’ia parashtruar kërkesën Kuvendit Komunal, dhe subvencionet nga qendra, donacionet nga organizatat ndërkombëtare dhe mënyra e punës është obligim që të ketë mbikëqyrje.

Xhylsime Feka, anëtare e Kuvendit- paraqiti një rast të njëjtë sikur rasti i Valmir Ramës, që është djali i Xhemajl Sogojevës, duke shtuar se edhe ai është me aftësi të kufizuara dhe nuk iu ka mundur udhëtimi së bashku me nxënësit tjerë, prandaj propozoi që edhe këtij rasti t'i ndihmohet.

Haki Maloku, përgjegjës për Sekretarinë e Kryetarit- tha se pasi që është aprovuar më herët Rregullorja për subvencione, është mirë që rastet tjera të procedohen në bazë të kërkesave të paraqitura, pasi që po krijohen probleme edhe me auditorët, në rastet kur merren vendime për rastet që nuk kanë paraqitur kërkesa me shkrim.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Lejohen mjete financiare nga fondi për subvencione në emër të Shoqatës së HANDIKOS-it në Vushtrri, në shumën prej 3.050 € për vitin 2011.

Nga shuma e cekur në nenin 1, 2.100 € lejohen për shpenzime operative, kurse 950 € lejohen për ekskursion tre ditor në Shqipëri për personat me aftësi të kufizuara, nën përkujdesjen e shoqatës nga neni paraprak.

10. Të ndryshme:

a. Propozim-vendimi për ndarje të plaketave dhe mirënjohjeve për nder të Ditës së Çlirimit.

Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së propozoi për ndarje të plaketës (post mortum) Selim Mërnican, i cili nuk ka kursyer as pasurinë, duke dhënë 4 shtëpi të cilat janë shndërruar në shkolla, dhe i cili dha jetën për lirinë e këtij vendi.

Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit- propozoi që t'i ndahet një mirënjohje (post mortum) Burhan Badivukun, i cili ishte një ndër veteranët e arsimit, një figurë patriotike dhe emblematike, që ka dhënë një kontribut të çmueshëm në periudhat më të vështira të luftës.

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së propozoi për ndarje të plaketës (post mortum) Adem Ademin, i cili ka qenë veprimtar i paepur i diasporës, dhe ka qenë i përndjekur, dhe 18 vite nuk ka pas të drejtë kthimi në Kosovë, kurse gjatë okupimit shtëpia e tij ka shërbyer si shkollë. Pastaj për ndarje të mirënjohjes propozoi Ilmi Gërgurin, i cili ka dhënë kontribut të madh për çështjen kombëtare dhe lirinë.

Hajrullah Muli, anëtar i Kuvendit- propozoi për ndarje të mirënjohjes Naman Kunovikun, i cili dha kontribut shumë vjeçar në arsim, dhe i cili dha jetën së bashku me bashkëshorten e vet për këtë vend.

Islam Krasniqi, anëtar i Kuvendit- propozoi për ndarje të mirënjohjes Halil Avdullin, i cili është një kontribues i madh për çështjen fetare dhe kombëtare.

Bahrije Pllana, anëtare e Kuvendit- propozoi për ndarje të plaketës Qazim Azemin, për kontributin e dhënë shumë vjeçar në arsim.

Xhylsime Feka, anëtare e Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të PDK-së propozoi për ndarje të mirënjohjes AKV "Hasan Prishtina" nga Vushtrria, pasi që kanë fituar disa çmime nëpër festivale.

Melihate Basholli, anëtare e Kuvendit- propozoi që Leonora Drevinjës t'i ndahet plaketë, pasi që ka arritur suksese të mëdha në shumë lëndë shkencore.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- propozoi për ndarje të plaketës (post mortum) Hysen Idrizin, veprimtar i lëvizjes ilegale, dhe disident i sistemit të Titos.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha që propozimi për mirënjohje për Xhevdet Hajrë Klinakun dhe Met Shytin të shoqatave të luftës, të ndryshohet duke propozuar t'iu ndahen plaketa.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, më 17 qershor 2011, nderohen me plaketa dhe mirënjohje siç vijon:

PLAKETA:

- 1. Avdullah Hadri (post mortum) - Një ndër mësuesit e parë dhe kuadër i shquar i arsimit i cili dha kontribut të pazëvendësueshëm në ngritjen e arsimit në komunën e Vushtrrisë.***
- 2. Ferat Muja (post mortum) - për sakrificë në mbrojtje të dinjitetit kombëtar.***
- 3. Selim Mërnica (post mortum)- për kontributin e dhënë në arsim gjatë luftës në Kosovë (shtëpia e tij ka shërbyer për zhvillimin e procesit mësimor), dhe ka dhënë jetën për lirinë e Kosovës.***
- 4. Adem Ademi (post mortum)- veprimtar i paepur i diasporës, i përndjekur politik. Gjatë okupimit shtëpia e tij ka shërbyer për zhvillimin e procesit mësimor.***
- 5. Hysen Idrizi (post mortum)- veprimtar i shquar i lëvizjes kombëtare shqiptare, dhe disident i sistemit komunist.***
- 6. Qazim Azemi- për kontributin shumë vjeçar të dhënë në lëmin e arsimit.***
- 7. Abedin Gjaka, për kontribut të jashtëzakonshëm gjatë luftës për çlirimin e Kosovës.***
- 8. Xhevdet (Hajrë) Klinaku, invalid i luftës së UÇK-së, për guxim dhe sakrificë gjatë luftës në Kosovë.***
- 9. Met Shyti, veteran i luftës së UÇK -së, për kontributin e dhënë gjatë luftës në Kosovë.***
- 10. Leonora Drevinja, nxënëse e kl. së IX-të në shkollës "Latif Berisha" në Dobërlukë, për suksese kulminante në gara nacionale, e cila ka zënë vendin e parë në Kosovë, duke arritur maksimumin e pikëve në lëndët: Matematikë, Fizikë, Gj. Angleze, Kimi dhe Biologji.***

MIRËNJOHJE:

- 1. Burhan Badivuku (post mortum)- veteran i arsimit, figurë patriotike dhe emblematike, që ka dhënë kontribut të çmueshëm në periudhat më të vështira të luftës.***
- 2. Avdullah Zhegrova - veprimtar i çështjes kombëtare dhe ish i burgosur politik.***
- 3. Behram Xhaka, veteran i arsimit, për kontribut të çmuar në arsimimin e gjeneratave të shumta në komunë.***
- 4. Enver Llapashtica - për punë të palodhshme dhe rezultate në skenën teatrale në Vushtrri.***
- 5. Emine Cimili - për angazhim dhe suksese të dalluara në punë, në lëmin e shëndetësisë në QKMF.***

6. **Halil Avdulli- kontribues i madh për çështjen fetare dhe kombëtare.**
7. **Ramiz Maliqi – për kontribut dhe profesionalizëm në implementimin e shumë projekteve të komunës.**
8. **Xhafer Islami - për angazhim dhe efikasitet në punë në administratën e komunës,**
9. **Kjartan Bjorson (Kryesues i Zyrës së Komisionit Evropian në Kosovë), për mbështetje financiare në realizim të projekteve me interes për komunën dhe qytetarët.**
10. **AKV “Hasan Prishtina”, Vushtrri - për sukseset e arritura, duke marrë disa çmime nëpër festivale.**
11. **DANIDA (organizatë daneze), për kontributin e dhënë në realizimin e projekteve në komunë.**
12. **SH.H.B. “Qeshme” në Vushtrri, për bashkëpunim të suksesshëm me institucionet e komunës në realizimin e disa projekteve humanitare.**
13. **Selim Kosumi, fermer i dalluar në kultivimin e perimeve cilësore dhe me rendiment të lartë.**
14. **Naim Fazliu, për biznes të suksesshëm.**

b. Pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- në emër të Grupi parlamentar të LDK-së kërkoi informata për këto çështje:

-Të na sigurohet informatë me shkrim për përfituesit e materialit ndërtimor për vitin 2010, ku do të përfshihej emri mbiemri i përfituesit, vendbanimi dhe vlera në euro, pastaj regjistri i atyre që kanë kërkuar, e nuk janë ndihmuar.

-Të na sigurohet një informatë rreth numrit të të punësuarëve (të rinj) në administratën komunale duke përfshirë periudhën janar 2010 deri më 30.04.2011, me emër dhe mbiemër dhe përgatitjen shkollore.

-Të na sigurohet një informatë lidhur me të punësuarit në administratën komunale të cilëve nuk iu është lëshuar akti i emërimit sipas LSHC-së, por u është vazhduar kontrata (emrin mbiemrin, përgatitjen shkollore dhe vendin e punës), natyrisht kjo duhet ta ketë një arsyetim pse nuk është zbatuar ligji për këta shërbyes civil.

Në fund i sugjeroi Kryetarit të Komunës që të ndërprehet dhënia e lejeve ndërtimore aty ku nuk janë aprovuar planet rregullative, sepse kjo është në kundërshtim me ligjin, dhe shtoi se ne kemi aprovuar më 12.06.2009 Planin Zhvillimor Komunal dhe Planin rregullativ ku vetëm në vija të trasha përcaktohet se ku lejohet ndërtimi, e nuk precizohet se çfarë ndërtimi, çfarë etazhiteti, edhe atëherë kur e kemi kundërshtuar aprovimin e tri planeve rregullative, e kemi bërë për këtë, se nuk janë zgjedh pjesët ku është më e atakuar me ndërtim, me përjashtim andej nga Ura e Gurit, ku kanë filluar me shkye tokën bujqësore pasi që e ndërruat destinimin, dikush do të përgjigjet për dhënien e këtyre lejeve, ku s’ka plane rregullative.

Syzana Sylja, anëtare e Kuvendit- tha se para disa seancave ka kërkuar nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe nga Drejtoria e Inspektionit që të largohen mbeturinat përreth shkollës fillore “Naim Frashëri”, por kjo kërkesë nuk është përfillë, dhe përsëri kërkoi nga drejtoritë në fjalë që të ndërmarrin masa dhe të largojnë këto mbeturina, pasi që mund të përhapet ndonjë epidemi tek nxënësit.

Ergin Sunguri, anëtar i Kuvendit- paraqiti një kërkesë nga Shoqata “Çeshme” për marrjen në shfrytëzim të ish-restorantit në Qendrën e Kulturës “Hasan Prishtina” për nevoja të shoqatës në fjalë. Në vazhdim paraqiti në detaje aktivitetet që i realizon Shoqata “Çeshme”.

Xhysime Feka, anëtare e Kuvendit- kërkoi nga Drejtoria për Arsim që të ndërmarrë masa për rritjen e sigurisë në qytet dhe përreth lokaleve ku mbahen mbrëmjet e semimaturës. Pastaj në emër të Grupit parlamentar të PDK-së kërkoi nga Drejtoria e Inspektionit një raport rreth ndërtimeve pa leje në komunën tonë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

**Procesmbajtësi:
Albanez Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi**